URDHËR
Nr. 305, datë 15.11.2022

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; neni 21, shkronja "a", të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; si edhe të nenit 30, pika 1, germa "a", të rregullores, "Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, për shkak të mungesës në punë për arsye objektive, të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së përfaqësimit të institucionit në marrëdhëniet me palët e treta, znj. Laerta Rooze, Sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
2. Delegimin e kompetencës së mësipërme për periudhën 23.11.2022–25.11.2022.
3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, znj. Laerta Rooze.
4. Znj. Laerta Rooze nuk mund të nëndelegojë këtë kompetencë.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Albana Shtylla